

**STATUTI**  
**I**  
**“EUROSIG INVEST” SH.A.**  
**SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE**

**Neni 1**  
**Emërtimi i Shoqërisë**

1. Themelohet një shoqëri aksionare me emërtimin “EUROSIG INVEST sh.a.– Shoqëri Administruese e Fondeve” (këtej e tutje e quajtur “Shoqëria”).
2. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.
3. “EUROSIG INVEST” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve, është një shoqëri aksionare, e themeluar rregullisht në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2**  
**Selia**

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën Rruga Jul Variboba Nr 21, Tiranë, Shqipëri.
2. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë.
3. Asambeja e Përgjithshme mund të vendosë krijimin ose mbylljen e selive dytësore, zyra, degë të shoqërisë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç selisë qendrore të Shoqërisë, në Tiranë, Shqipëri. Asambleja e Përgjithshme mund t’ia delegojë këtë kompetencë Administratorit.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e pakufizuar.
2. Shoqëria mund të priset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme apo në bazë të dispozitave të ligjit të zbatueshëm.

**Neni 4**  
**Objekti**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

1. Administrimi i Fondeve të Pensionit Vullnetar.
2. Administrimi i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive me ofertë publike;
3. Konsulenca dhe veprimtari të tjera në përputhje me kufizimet e legjislacionit të fushës të pikave 1 dhe 2 më lart.

## **Neni 5**

### **Kapitali i Shoqërisë**

1. Kapitali i nënshkruar dhe i paguar tërësisht i shoqërisë është 32,000,000.00 lekë i përberë prej 32,000 aksione me vlerë nominale 1,000 (njëmijë) lekë secili.
2. Kapitali aksionar i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para dhe zotërohet nga aksionarët e Shoqërisë si më poshtë vijon:
  - a) Pjesëmarrja aksionare e Insig Jetë sh.a. është në nivelin 51.00%, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 16,320,000.00 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqindnjëzet mijë) si dhe me 16,320 (gjashtëmbëdhjetë mijë e treqindnjëzet) aksione.
  - b) Pjesëmarrja aksionare e EUROSIG sh.a. është në nivelin 49%, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 15,680,000.00 (pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqindetëdhjetë mijë) si dhe me 15,680 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) aksione.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë pa kufizim kapitalin me anë të emetimit të aksioneve të reja, zmadhimit të kufizuar të kapitalit, zmadhimit të autorizuar të kapitalit, përfshirjes së rezervave të disponueshme dhe fitimeve të pashpërndarë kapitalin ekzistues dhe rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistues. Kontributet në të holla për aksione të nënshkruara sipas vendimit të Asamblesë së Aksionarëve për rritjen e kapitalit duhet të paguhet të paktën  $\frac{1}{4}$  të vlerës nominale në momentin e nënshkrimit. Pjesa që mbetet do të paguhet në përputhje me vendimin e Këshillit të Administrimit dhe në përputhje të plotë me rregullat e vendosura për këtë qëllim nga autoritetet publike mbikëqyrëse të fushës objekt veprimtarie.
4. Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë me anë të zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve, zvogëlimit të thjeshtuar të kapitalit ose anulimit të aksioneve, por në asnjë rast kapitali nuk mund të zvogëlohet nën vlerën minimale të parashikuar nga legjislacioni i fushës së veprimtarisë objekt i shoqërisë.

## **Neni 6**

### **Aksionet**

1. Të gjithë aksionet janë të zakonshëm, nominativë dhe të pandashëm. Çdo aksion i jep zotëruesit të tij të drejtën e një vote. Të drejtën e ushtrimit të votës e kanë aksionarët e regjistruar në Regjistrin e Aksionarëve
2. Regjistri mbahet pranë Shoqërisë nga Administratori i Shoqërisë ose nga çdo person tjetër i caktuar prej tij, i cili regjistron të dhënat me kërkesën e personit të interesuar, kundrejt paraqitjes së dokumentit që provon të drejtën përkatëse. Të gjitha ndryshimet në lidhje me aksionet duhet të pasqyrohen/regjistrohen në Regjistër. Informacioni i Regjistrit të Aksioneve duhet të publikohet në faqen e internetit të Shoqërisë.
3. Të gjithë aksionet regjistrohen në Regjistrin/Librin e Aksionarëve të Shoqërisë, që mban të dhënat:
  - a) emri i aksionarit,

- b) adresa,
  - c) numri dhe vlera nominale e aksioneve të zotëruara nga aksionari, dhe
  - d) data e kryerjes së regjistrimit.
4. Aksionet e Shoqërisë janë lirisht të transferueshme midis Aksionarëve të Shoqërisë, pjesërisht ose plotësisht. Transferimi mund të realizohet nëpërmjet shitjes, trashëgimisë, dhurimit ose në çdo formë tjetër të parashikuar në ligj. Transferimi palëve të treta duhet t'u njoftohet me shkrim Shoqërisë dhe aksionarëve të tjerë të Shoqërisë për tu dhënë mundësinë e ushtrimit të së drejtës së parablerjes. Transferimi i aksioneve nuk mund të realizohet pranë të tretëve, nëse aksionarët e tjerë ekzistues kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes me të njëjtat kushte brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit.

## **Neni 7**

### **Organet e Shoqërisë**

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli i Administrimit, si organ i vetëm administrimi, i cili ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje, të veprimtarisë së shoqërisë (sistemi me një nivel).

## **Neni 8**

### **Asambleja e Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.
2. Aksionari ka të drejtën të marrë pjesë në asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa aksione zotëron. Një aksionar mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet në një vendndodhje të ndryshme nga selia e Shoqërisë, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë. Aksionarët që nuk janë të pranishëm fizikisht në mbledhjen e thirrur për t'u zhvilluar, mund të jenë pjesëmarrës në mbledhje, duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit, telekonferencë, videokonferencë apo mjete të tjera të komunikimit elektronik, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të jenë identifikuar dhe t'u jetë dhënë mundësia për të ndjekur diskutimin dhe komunikimin e ndërsjellë në kohë reale nga një vendndodhje tjetër, duke përdorur mjete teknike të nevojshme për përdorimin proporcional për arritjen e këtyre qëllimeve. Nëse plotësohen dhe zbatohen këto kritere, Asambleja e Aksionarëve do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhet kryetari dhe sekretari i mbledhjes, me qëllim mbajtjen e minutave të takimit, nënshkrimin e procesverbaleve përkatëse.
4. Asambleja e Përgjithshme do të thirret në rastet e parashikuara nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Statuti dhe sa herë që është e nevojshme me qëllim mbrojtjen e interesave të Shoqërisë. Mbledhja e

- zakonshme e asamblesë se përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda muajit Qershor, me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor të vitit të mëparshëm.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët dhe në rastet e parashikuara nga ligji nga anëtarët e Këshillit të Administrimit, si dhe mund të thirret nga aksionarët në përputhje me nenin 139 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
  6. Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme do t'u njoftohet aksionarëve me shkrim apo nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë informacion mbi çështjet që do të diskutohen, vendin, orën dhe datën, si edhe elementet e tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve të paktën 21 ditë kalendrike përpara datës së parashikuar të mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbajtur rregullisht edhe në rast se nuk janë respektuar formalitetet e thirrjes, në rast se janë të pranishëm të gjithë Aksionarët dhe shprehen dakord për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.
  7. Aksionarët mund të caktojnë një person që do të kryesojë Mbledhjen e Aksionarëve. Asambleja e Përgjithshme emëron një sekretar të mbledhjes i cili mund të jetë aksionar ose jo aksionar dhe mban procesverbalin. Kryetari i Asamblesë së Aksionarëve ka tagra të plota për të verifikuar autorizimet/prokurat dhe rregullsinë e tyre, të drejtat e aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, dhe të përcaktojë nëse kjo asamble është e thirrur rregullisht dhe nëse është i pranishëm kuorumi i aksionarëve me qëllim marrjen e vendimeve të vlefshme; gjithashtu ai ka të drejtën të drejtojë diskutimet dhe të përcaktojë mënyrat dhe procedurat e votimit. Procesverbalet e mbledhjes nënshkruhen nga Kryetari i Mbledhjes dhe nga Sekretari.
  8. Asambleja e Përgjithshme do të mbahet në gjuhën Shqipe. Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve do të nënshkruhen nga Kryetari dhe sekretari i asamblesë, ose nga noteri publik nëse kjo është e nevojshme.
  9. Asambleja e Përgjithshme merr vendime, me kuorum sipas ligjit për shoqëritë tregtare, për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
    - a) përcaktimin e politikave tregtare;
    - b) ndryshime të statutit;
    - c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit (sistemi me një nivel);
    - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe audituesve të jashtëm (Auditues Ligjor);
    - d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;
    - dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
    - e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
    - ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
    - f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
    - g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
    - gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;

- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
  - j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
10. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin Audituesit Ligjor.

## Neni 9

### Këshilli i Administrimit (sistemi me një nivel)

1. Këshilli i Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë individë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme për një afat 3 (tre) vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Vetëm 1 (një) prej anëtarëve është dhe Administrator i Shoqërisë (ekzekutiv). Anëtarët mund të revokohen përpara afatit për çfarëdo arsye nga Asambleja e Përgjithshme. Anëtarët e Këshillit duhet të plotësojnë kërkesat e ligjit nr.9901/2008 “per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; ligjit nr. 10197/2009 “per fondet e pensionit vullnetar”, Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe të akteve rregullatore të organit mbikëqyrës (AMF). Anëtarët e parë të Këshillit të administrimit janë: Ilir Çeliku, Blediana Hyna, Elvis Koçi (ekzekutiv). Kryetar i parë është Ilir Çeliku dhe zëvendës kryetare Blediana Hyna.
2. Këshilli i Administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
  - a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
  - c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
  - ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
  - d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
  - dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
  - e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga Administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e Anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
  - ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një Auditues Ligjor, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit e Administratorëve. Raporti i Këshillit të Administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
  - f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorin/ët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre, nëse ka më shumë se një;

- g) të përcaktojë shpërblimin e administratorit/ëve;
  - gj) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
  - k) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
  - i) të kryejë veprimet e tjera, zbatojë detyrimet dhe mbajë përgjegjësi sipas përcaktimeve në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në ligjin nr.10197, datë 10.12.2009: "Për fondet e pensionit vullnetar", në ligjin nr.56/2020: "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", në ligjin nr. 62/2020, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit", si dhe në Statut.
  - j) të miratojë rregulloret e brendshme të shoqërisë si dhe ndryshimet përkatëse të tyre.
3. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), Këshilli i Administrimit duhet të thërrasë menjëherë Asambleenë e Përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme, apo për miratimin e transaksionit.

## **Neni 10**

### **Mbledhjet e Këshillit të Administrimit**

1. Këshilli i Administrimit thirret zakonisht të paktën çdo tre muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë, me thirrjen e Kryetarit ose, në mungesë të tij nga Zëvendëskryetari. Mbledhjet e Këshillit të Administrimit mbahen në gjuhën Shqipe.
2. Kryetari, në mungesë të tij Zëvendëskryetari i caktuar për ta përfaqësuar, do të thërrasë Këshillin e Administrimit në bazë të një kërkesë të arsyetuar të Administratorit/ëve ose të paktën dy anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Nëse kjo kërkesë mbetet pa përgjigje për dhjetë ditë, atëherë autori i saj mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit, duke përcaktuar dhe Rendin e Ditës.
3. Thirrja kryhet 10 (dhjetë) ditë para mbledhjes nëpërmjet letrës, telegramit, teleks ose faks. Thirrja mund të bëhet edhe gojarisht dhe pa kufij kohor nëse anëtarët e Këshillit të Administrimit do ta pranojnë. Në rast urgjence mbledhja mund të thirret me komunikim elektronik të dërguar të paktën 5 (pesë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës. Në rast se Kryetari mungon ose për një arsye nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, të gjitha kompetencat e tij i transferohen Nënkyetarit. Edhe nëse nuk janë përmbushur të gjitha formalitetet e nevojshme për thirrjen, Këshilli i Administrimit do të quhet i mbledhur rregullisht nëse të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit janë të pranishëm në mbledhje. Mbledhja mund të mbahet dhe me telekonferencë apo vidokonferencë me kusht që të gjithë të pranishmit të mund të identifikohen dhe t'u jepet mundësia për të ndjekur diskutimet dhe për të marrë pjesë në to. Nëse plotësohen këto kushte dhe në rastet kur zbatohen këto kritere, mbledhja e Anëtarëve të Këshillit do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.

4. Këshilli i Administrimit emëron një Sekretar për të mbajtur procesverbalet e mbledhjeve, i cili mund të mos jetë anëtar. Procesverbalet nënshkruhen prej Sekretarit dhe prej Kryetarit, në mungesë të tij prej Zëvendëskryetarit. Procesverballi, përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara dhe vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverballit, nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverballit.
5. Vendimet e Këshillit të Administrimit vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit është vendimtare.
6. Vendimet e Këshillit të Administrimit, mund të merren sipas përcaktimeve të statutit apo të rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit, ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje

## **Neni 11** **Administratorët**

1. Këshilli i Administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë, si administratorë të shoqërisë, për një afat, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen. Administratori/Administratorët emërohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", si dhe të ligjit nr.56/2020, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".
2. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:
  - a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
  - b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin Këshillit të Administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
  - d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) të kryejnë regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, date 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, apo të ligjeve të tjera;
  - e) të raportojnë përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
  - ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe në ligjin nr.10 197, date 10.12.2009: "Për fondet e pensionit vullnetar", në ligjin nr.56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve

kolektive”, në rregulloret e autoritetit mbikëqyrës (AMF) si dhe ato të deleguara nga Këshilli i Administrimit

## **Neni 12**

### **Auditi i Brendshëm i Shoqërisë**

1. Auditi i Brendshëm i Shoqërisë përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të përhershëm të emëruar nga Këshilli i Administrimit dhe ushtron veprimtarinë nën mbikëqyrjen direkt të Këshillit të Administrimit. Këshilli i Administrimit, përcakton dispozitat rregulluese lidhur me realizimin e kontrollit financiar të brendshëm të shoqërisë dhe miraton planin vjetor të auditimit.
2. Auditi i Brendshëm i Shoqërisë i raporton Këshillit të Administrimit të paktën katër herë në vit.
3. Auditi i Brendshëm është përgjegjës:
  - a) për të rekomanduar parimet e mirëdrejtimit të shoqërisë, politikat dhe strategjitë për t’iu përmbajtur parimeve dhe për të vlerësuar çdo vit zbatimin e këtyre politikave e strategjive. Parimet e mirëdrejtimit të shoqërisë duhet të përfshijnë standartet e kryerjes së biznesit e të sjelljes etike të administratorëve, të drejtuesve e të personelit tjetër, politikat për transaksionet private, bërjen e marrëveshjeve me vetveten dhe praktika të tjera transaksionesh, kur palët nuk janë të pavarura;
  - b) për të mbikëqyrur veprimet e shoqërisë administruese dhe për të dhënë udhëzime për të, në mënyrë të përditshme, për të siguruar se shoqëria u përmbahet objektivave e politikave të miratuara nga Këshilli i Administrimit dhe legjislacioni përkatës;
  - c) për të dhënë rekomandime për Këshillin e Administrimit, për rishikim dhe miratimin prej tij të objektivave, strategjive, planeve të biznesit dhe politikave madhore, që udhëheqin veprimin e institucionit;
  - ç) për t’i siguruar Këshillit të Administrimit informacionin përkatës, të hollësishëm e në kohën e duhur, në mënyrë që ky Këshill të mund të rishikojë objektivat e biznesit, strategjinë e biznesit dhe politikat dhe për t’i bërë strukturat më të larta drejtuese përgjegjëse për pozicionin e tyre.
4. Këshilli i Administrimit mund ta delegojë funksionin e Auditit të Brendshëm në një strukturë të përshtatshme jashtë shoqërisë. Kontrata e delegimit duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e fushës dhe të përfshijë të gjitha pikat e mësipërme të këtij neni.

## **Neni 13**

### **Struktura e Administrimit të Riskut**

1. Struktura e Administrimit të Riskut, përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të përhershëm të emëruar nga Këshilli i Administrimit dhe ushtron veprimtarinë nën mbikëqyrjen direkt të Këshillit të Administrimit.
2. Struktura e riskut informon çdo muaj Administratorin dhe raporton çdo tre muaj tek Këshilli i Administrimit.
3. Struktura e Administrimit të Riskut është përgjegjëse që:



- a) t'i rekomandojë Këshillit të Administrimit miratimin e një strukture të administrimit të riskut, që të identifikojë e të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme risqet, para të cilave janë të ekspozuara asetet e fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit; dhe shoqëria administruese, përfshirë, të paktën, riskun e tregut, riskun e kredisë, riskun operacional, riskun e reputacionit, riskun ligjor dhe riskun e agjencisë;
- b) të mbikëqyrë veprimet e shoqërisë administruese dhe administrimin nga ana e saj të fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit;
- c) të japë udhëzime të përditshme, për të siguruar që shoqëria administruese, vetë apo/ dhe në rolin e administrimit të fondit/fondeve të pensionit; dhe fondit/fondeve të investimit, vepron brenda limiteve të riskut, të vendosura nga Këshilli i Administrimit dhe të shprehura në kontratën e fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit dhe në prospekt të fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit.
- ç) të përcaktojë saktë dhe në mënyrë të pavarur vlerën e derivativeve financiare, të tregtuara në tregje të tjera të rregulluara, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 14 Politika e Investimeve**

1. Këshilli i Administrimit miraton politikat e investimit, në përputhje me ligjin dhe rregulloret në zbatim të këtij ligji, mbikëqyr administrimin e investimeve të fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit, siguron që përbërja dhe diversifikimi i tyre të përcaktohen në mënyrën e duhur në politikën e investimit, të fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit. Politika e investimit, në kuptim të kësaj pike, përfshin:
  - a) kufijtë për shumat, që mund të mbahen në lloje të veçanta investimesh;
  - b) përcaktimin e qartë të llojeve të instrumenteve financiare dhe të çdo asemi tjetër të lejuar, në të cilin mund të investohet fondi i pensionit; dhe fondi i investimit;
  - c) rregulla për ruajtjen e aseteve të anëtarëve;
  - ç) vlerësimin e përputhjes së duhur të aseteve dhe të detyrimeve;
  - d) procedurën e duhur për mbikëqyrjen e nivelit të likuiditetit;
  - e) çdo përcaktim që parashikohet në ligjin nr.10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", ligjit nr.56/2020, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Këshilli i Administrimit miraton sistemin e administrimit të riskut për fondin/fondet e pensionit, fondin/fondet e investimit që përfshin përcaktimin dhe monitorimin e politikave, me qëllim identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin, në mënyrë të vazhdueshme, të të gjitha risqeve kryesore.

#### **Neni 15 Audituesit e Jashtëm**

1. Kontrolli i jashtëm financiar i shoqërisë administruese të fondit/fondeve të pensionit; sipërmarrjeve të investimeve kolektive, bëhet nga një ose më shumë Auditues Ligjorë, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit.
2. Llogaritë e shoqërisë dhe të fondit/fondeve të pensionit, fondit/fondeve të investimet (sipërmarrjeve të investimeve kolektive) që administrohen auditohen çdo vit ushtrimor dhe në afate të tjera të ndërmjetme, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi, dhe në shoqëritë e kontrolluara, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të paraqesë të dyja grupet e pasqyrave financiare vjetore të kontrolluara, atë individuale dhe ato të konsoliduara.
3. Audituesi/it e jashtëm që emërohen nga Asambleja e Aksionarëve, duhet që të gëzojnë statusin e personit juridik të miratuar nga autoriteti mbikëqyrës (AMF).

#### **Neni 16** **Viti financiar**

Viti financiar apo ushtrimor fillon më 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti

#### **Neni 17** **Rezerva ligjore dhe Rezervat e Tjera**

1. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet Shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5% të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jete e barabartë me 10 % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë në përputhje me ligjin e zbatueshëm.
2. Me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të aksionarëve sipas parashikimeve të këtij Statuti, mund të parashikohen krijime rezervash të tjera nga fitimet vjetore.
3. Shoqëria llogarit dhe ndan dividendet, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumatat e caktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 18** **Prishja dhe Likuidimi**

Shoqëria konsiderohet e prishur në rastet e parashikuara nga ligji i zbatueshëm. Në rast përfundimi, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidues dhe tagrat përkatëse në përputhje edhe me kërkesat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, si dhe ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", ligjit nr.56/2020, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

#### **Neni 19** **Blerja, Bashkimi dhe Transferimi i Shoqërisë**

26.1 Shoqëria mund të blejë dhe të zotërojë aksione në një shoqëri tjetër, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, date 14.04.2008, si dhe ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009,

“Për fondet e pensionit vullnetar”, ligjit nr.56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, me vendim të Asamblesë së Aksionarëve, si dhe pas dhënies së pëlqimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Lexuar, kuptuar, miratuar dhe nënshkruar nga aksionarët:

Për INSIG JETË sh.a. (shoqëri sigurimi jete) zotërues në 51.00 % të paketës aksionare:  
Z. Elvana Cara (përfaqësues i autorizuar i Insig Jetë sh.a.)

Për EUROSIG sh.a. (shoqëri sigurimi) zotërues në 49.00 % të paketës aksionare:  
Z Xhevdet Kopani (përfaqësues i autorizuar i EUROSIG sh.a.)

Tiranë, më 02 / 11 / 2022

